

behgjet pacolli - mgr
ceo mabetex group

Republika e Kosovës

Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit

Prishtinë, 30 Mars 2010

Lënda: Deklarim i gjendjes së pasurisë

Të nderuar,

Sikurse edhe në vitet e kaluara edhe tani ju dërgoj formularin e plotësuar për gjendjen time ekonomike.

Qysh në fillim ju garantoj se çdo gjë që ka të bëjë me mirqenjen time ekonomike ne Kosove, vjen ekskuzivisht nga burimet e fituara jashte Kosoves, si rezultat i punes time, (jashte Kosoves), per 35 vite.

Ne kete vit burimeve te lartecekura u shtohen u shtohen, paga ime e deputetit ne muaj rreth 1200 euro, (bashkangjitur shihni dokumentacionin), shume kjo e cila u shperndahet per bursa studenteve ne Universitetet e Kosoves dhe te ardhurat nga ambientet e dhena me qera K.S.Siguria 12.000 eu ne muaj, (bashkangjitur shihni dokumentacionin) shume kjo e cila shperndahet per sherimin e pacijenteve te Kosoves jashte vendit.

Ne ndryshim nga deklarata e vitit te kaluar, qe nga fillimi i ketij viti une jam terhequr nga udheheqesia e shume subjekteve te Grupit te Mabetex-it duke perfshire edhe MABCO firme kjo si shtylle kryesore e Mabetex-it qe ka ndikuar ne reduktimin e te hyrave te mija vjetore (kjo do te pasqyrohet ne formularet annex te kesaj deklarate.

Koheve te fundit me mua ne Kosove shpesh jeton edhe familja ime e ngushte e sidomos femijet e mij te vegjel dhe bashkeshortja per te cilet ekziston arsyeja reale qe te jem gjithmone vigjilent per parandalimin e cdo rreziku duke i pare rrethanat ne Kosove, per kete ju lus dhe kerkoj nga ju qe ky raport te jete konfident dhe pa miratimin tim te mos publikohet.

Publikimi i ketij raporti do te rrezikonte sigurine time dhe te familjes dhe njekohesisht do te binte ne kundershtrim poashtu edhe me ligjet qe e rregullojne funksionimin e Kompanive me aksione anonime ne Zvicer ku ende jam pjese e tyre ne forme te aksionarit kryesor edhe pse e ceka me lart, jam terheqe nga udheheqesite e ketyre.

Prandaj ju lus qe informatat ne kete raport te perdoren vetem per ceshtjet e qellimta prej nga edhe buron nevoja e ketij lloj deklarimi. Qe nga tani deklaroj, une si nenshkruer i kesaj letre se nuk autorizoj publikimin e te dhenave ne formularet e bashkangjitur.

Per cdo pasoje qe rrjedhe nga publikimi i kesaj deklarate , ju do te mbani pergjegjesine .

Me nderime,

Behgjet Pacolli

